

VENDIM
Nr.652, datë 30.9.2004

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË JOPUBLIKE “MARUBI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë jopublike “Marubi”, me degë “Filmi dhe multimedia”, me seli qendrore në Tiranë, në adresën: Rruga “Aleksandër Moisiu”, nr.78 (Kinostudio “Shqipëria e Re”).

2. Diploma universitare e shkollës së lartë jopublike “Marubi” do të jetë:
“Specialist i lartë në film dhe media”, me tre vite akademike, në profilet:

- Regjisorë
- Skenar
- Kamera
- Montazh."

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të kursit të studimit dhe të zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano